



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.12.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **PE -VLA-KU**" SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtëpisë së të moshuarve në Gjakovë", Nr. i prokurimit- 632-23-11220-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-161 -521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " PE -VLA-KU" SH.P.K. DEGA NË KOSOVË. e dt.21.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtëpisë së të moshuarve në Gjakovë", Nr. i prokurimit- 632-23-11220-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-161 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 13.12.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 13.12.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

- Pretendimi juaj i parë nuk qëndron sepse, nga Autoriteti kontraktues ka kërkuar një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi mbrojtje e mjedisit, të jetë i certifikuar dhe të prezantoj certifikatën e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit.
- Pretendimi juaj lidhur me buldozerin D4 dhe makinën për prerjen e pusetave nuk qëndron, sepse ju nuk keni ofruar dëshmi siç është kërkuar në FDT ;
- Pretendimi juaj lidhur me makinën për prerjen e pusetave nuk qëndron, sepse ju nuk keni ofruar dëshmi siç është kërkuar në FDT .Pretendimi se kjo kërkesë prej fillimit të tenderit ka qenë tendencioze, nuk qëndron, sepse kjo kërkesë as nuk është përmendur në kërkesën tuaj për rishqyrtim të dt.31.10.2023, ku bazuar në kërkesën tuaj për rishqyrtim është bërë përmirësimi i dosjes së tenderit dhe janë hequr disa kërkesa të Autoritetit kontraktues .
- Pretendimi juaj lidhur me sharrën për prerjen e asfaltit është pjesërisht i bazuar, por i njëjti nuk e ndërron Vendimin e autoritetit kontraktues, për arsye se të gjitha pretendimet tjera nuk qëndrojnë.

Pretendimet për GOE ALPING SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM ; N.N.P. ATC COM SH.P.K.; BAB Groups SH.P.K. :

- Pretendimi juaj lidhur me plotësimin e Aneksit 6.1-afati i implementimit dhe Periudha garantuese, nuk qëndron, sepse ky aneks është plotësuar nga lideri i grupit(i cili është i autorizuar në emër të grupit) dhe Autoriteti kontraktues e merr si të mirëqenë.
- Pretendimet e juaja lidhur me Vendimet e Gjykatës nuk qëndrojnë, sepse vlefshmëria e këtij vërtetimi është 6 muaj dhe GOE ka sjellë vërtetimet për katër anëtarët e grupit ashtu siç i ka kërkuar Autoriteti kontraktues.
- Pretendimi juaj lidhur me atë se anëtarëve të konsorciumit ju mungojnë të dhënat financiare nuk qëndron, sepse Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, mjafton që t'i plotësoj njëri anëtarë i grupit.
- Pretendimi juaj lidhur me listat e punëtorëve nuk qëndron, sepse GOE ka plotësuar numrin e punëtorëve siç është kërkuar në FDT.
- Sa i përket stafit teknik të "ACT Com" sh.p.k., ka prezantuar listën e ATK-së, dhe të gjithë punëtorët e përmendur nga ju kanë kontrata pune dhe për Autoritetin kontraktues kjo plotëson kërkesën e FDT-ë dhe merret si e mirëqenë.

- Pretendimi juaj lidhur me atë se për pozitën për punime me pllaka qeramike, graniti dhe mermer si dhe suvatim dhe ngjyrosje , nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues në FDT-ë, nuk ka kërkuar që punëtori të jetë i certifikuar nga institucioni përkatës, por vetëm të prezantoj dëshmi se është i kualifikuar për atë lëmi, për dallim nga inxhinieri i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi mbrojtje e mjedisit, ku është kërkuar të jetë i certifikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit dhe të prezantoj certifikatën e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit.
- Pretendimi juaj se inxhinieri i makinerisë Avni Sfishta nuk e ka CV e nënshkruar, nuk qëndron, sepse në FDT nuk kërkohej që të prezantoj CV-në e nënshkruar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gütaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
 Zyrës së Kryetarit të Komunës;
 Te gjitha palëve të interesuara;
 Arkivit të Komunës